

Përmbledhje

Parashikimet e BQK-së për vitin 2016 sugjerojnë rritje ekonomike prej 3.7 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPV-së. Në TM1 2016, ekonomia e Kosovës është karakterizuar me inflacion prej 0.1 përqind (-0.4 përqind në TM1 2015).

Spektori fiskal gjatë TM1 2016 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Rritje më e lartë është evidentuar tek të hyrat kufitare, përderisa sa i përket shpenzimeve buxhetore, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje. Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc buxhetor prej rreth -2.8 milionë euro (-5.1 milionë euro në TM1 2015).

Spektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore. Në të njëjtën periudhë, bilanci pozitiv në llogarinë e shërbimeve u karakterizuan me rritje. Rritja e deficitit të mallrave gjatë TM1 2016 kryesisht rezultoi nga rënia e vlerës së eksportit të mallrave për 5.4 përqind dhe në të njëjtën kohë, rritja e vlerës së mallrave të importuara për 12.5 përqind. Dy burime të rëndësishme të rritjes ekonomike, remitencat dhe IHD-të, u karakterizuan me rënie në TM1 2016. Remitencat shënuan rënie vjetore prej 2.2 përqind, përderisa IHD-të u karakterizuan me rënie prej 12.9 përqind.

Kreditë e sektorit bankar përsheptuan ritmin e rritjes, duke shënuar normë vjetore të rritjes prej 8.8 përqind në mars 2016 (4.3 përqind në mars 2015). Kreditë e sektorit bankar shënuan rritje pothuajse për të gjithë sektorët e ekonomisë. Po ashtu, TM1 2016 u karakterizuan me rënie të mëtejme të normës së interesit në kredi, gjë që pritet të ketë rol të rëndësishëm në rritjen e kërkesës së brendshme në vend. Depozitat shënuan normë të rritjes prej 3.5 përqind (5.9 përqind në mars 2015).

Spektori bankar vazhdoi të përmirësojë cilësinë e portofolit kreditor. Norma e kredive jopërfomuese u zvogëluar në 5.9 përqind (8.1 përqind në mars 2015). Niveli kapitalizimit të sektorit bankar shënoi përforsim të mëtutjeshëm, përderisa edhe pozicioni i likuiditetit qëndroi në gjendje të kënaqshme.

Më përsheptim të aktivitetit dhe përmirësim të performancës financiare u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, përfshirë sektorin mikrofinanciar, sektorin e sigurimeve dhe sektorin pensional.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	04
Ekonomia e Kosovës -----	06
Sektori Real-----	06
Sektori Fiskal-----	09
Sektori i Jashtëm-----	10
Sistemi Financiar-----	13
Sektori Bankar-----	13
Sektori Pensional-----	23
Sektori i Sigurimeve-----	24
Sektori Mikrofinanciar-----	25
Tregu i Letrave me Vlerë-----	30

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë-----	04
Figura 2. Norma mesatare e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së-----	04
Figura 3. Norma e inflacionit-----	06
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	07
Figura 5. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit-----	07
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit-----	07
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	08
Figura 8. Regjistri i bizneseve-----	08
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	08
Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar-----	10
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 12. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	11
Figura 13. Remitencat-----	11
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	12
Figura 15. Asetet e sistemit financiar-----	13
Figura 16. Asetet e bankave komerciale-----	13
Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave-----	14
Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	14

Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	15
Figura 20. Rritja e kredive sipas sektorëve ekonomik	15
Figura 21. Kreditë sipas afatit të maturimit	16
Figura 22. Depozitat	16
Figura 23. Struktura e depozitave	17
Figura 24. Struktura e depozitave sipas maturimit	17
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita	18
Figura 26. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve	18
Figura 27. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve	18
Figura 28. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik	19
Figura 29. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare	19
Figura 30. Norma mesatare e interesit në depozita	20
Figura 31. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje	20
Figura 32. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare	20
Figura 33. Profiti neto i sektorit bankar	21
Figura 34. Vlera e shpenzimeve sipas kategorive	21
Figura 35. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	21
Figura 36. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar	21
Figura 37. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	22
Figura 38. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë dhe norma e rritjes së NPL-ve	22
Figura 39. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës	22
Figura 40. Asetet e sektorit pensional	23
Figura 41. Asetet e sektorit të sigurimeve	24
Figura 42. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara	24
Figura 43. Asetet e sektorit mikrofinanciar	26
Figura 44. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar	26
Figura 45. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive	26
Figura 46. Kreditë sipas maturitetit	26
Figura 47. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik	27
Figura 48. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar	27
Figura 49. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik	27
Figura 50. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar	28
Figura 51. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik	28
Figura 52. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar	29
Figura 53. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar	29
Figura 54. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë	29
Figura 55. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë	30
Figura 56. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit	31
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së	04
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	33


SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicërran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërfomuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Gjatë TM1 2016, eurozona u karakterizua me një dinamikë të përshpejtuar të aktivitetit ekonomik. Dobësimi i kërkesës së jashtme, si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vendet në zhvillim (Kina, Rusia dhe Brazili), rritjes së tensioneve gjeopolitike dhe fluksit të refugjatëve, u neutralizua nga përforcimi i mëtejme i kërkesës së brendshme në eurozonë, veçanërisht konsumit privat. Gjithashtu, rënia e mëtejme e çmimeve të naftës në TM1 2016 është reflektuar në rritje të shpenzimeve të konsumatorëve. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në TM1 2016, ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 1.7 përqind. Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, norma reale e rritjes ekonomike ishte 0.6 përqind (figura 1). Rritja e aktivitetit ekonomik në TM1 2016 kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të BPV-së në ekonomitë qendrore të eurozonës, veçanërisht në Gjermani, Francë dhe Spanjë (tabela 1).

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2016)


Në TM1 2016, eurozona u karakterizua me normë mesatare të inflacionit prej 0.0 përqind, përderisa vlerësimet e Eurostat-it për muajin prill tregojnë për

një rënie të mëtejme të shkallës së inflacionit në -0.2 përqind. Aktiviteti më i dobët i ekonomisë globale, si dhe çmimet e ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare priten të reflektohen në presione të ulëta inflacioniste gjatë tërë vitit 2016. Sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në vitin 2016 pritet të jetë rreth 0.1 përqind.

Për të evituar deflacionin potencial dhe për të rikthyer shkallën e inflacionit më afër caktuar prej 2 përqind, si dhe për të stimuluar një rritje më dinamike të ekonomisë së eurozonës, në mars të vitit 2016 BQE-ja lansoi një pako të masave të reja në kuadër të programit të lehtësimit sasior. Më konkretisht, pakoja e re stimuluese e BQE-së përfshinë zgjerimin e programit lehtësues përmes rritjes së vëllimit të blerjes së letrave me vlerë nga 60 miliardë në 80 miliardë euro në muaj. Gjithashtu, përveç blerjes së borxheve të qeverive, skema e re pritet të përfshijë edhe blerjen e bondeve të korporatave private, duke rritur kështu gamën e investimeve edhe drejtë tregjeve private të aksioneve. Për më tepër, BQE-ja ka vendosur të reduktojë edhe më tej normën e interesit në depozita në -0.4 përqind nga -0.3 përqind, që nënkupton se bankat do të obligohen të paguajnë kosto më të lartë për të depozituar fondet e tyre në BQE. Kjo masë synon të dekurajojë bankat private të eurozonës të depozitojnë fondet e tyre në BQE, duke i nxitur ato të rrisin kreditimin për bizneset edhe ekonomitë familjare. Përfundimisht, BQE-ja ka zvogëluar normën bazë të interesit, gjegjësisht normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit, në zero përqind

nga 0.05 përqind sa ishte që nga shtatori i vitit 2014.

Figura 2. Norma mesatare e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2015 dhe zgjerimi i mëtejshëm në mars 2016 është reflektuar në rënien e normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në TM1 2016, norma 1 mujore e Euribor-it kanë rënë në mesatarisht -0.26 përqind nga -0.15 përqind në TM4 2015. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhë 12 mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.01 përqind në TM1 2016, nga mesatarja prej 0.09 përqind në TM4 2015 (figura 2).

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë TM1 2016 vlerësohet të jetë përforcuar. Përforcimi i kërkesës së jashtme si rezultat i rikuperimit të eurozonës, rritja e konsumit privat dhe rritja e investimeve kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas FMN-së, shtetet e Ballkanit Perëndimor pritet të shënojnë një rritje mesatare të BPV-së prej 3.3 përqind në vitin 2016. Mali i Zi, Maqedonia dhe Shqipëria priten të karakterizohen me një normë më të lartë të rritjes ekonomike (4.7, 3.6 përkatësisht 3.4 përqind), përderisa Serbia pritet të

shënoj normën më të ulët të rritjes ekonomike edhe në vitin 2016 (1.8 përqind) (tabela 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016
Austria	0.3	0.4	0.9	1.2
Franca	0.7	0.2	1.1	1.1
Gjermania	0.4	1.6	1.5	1.5
Greçia	-3.2	0.7	-0.2	-0.6
Italia	-1.7	-0.3	0.8	1.0
Spanja	-1.7	1.4	3.2	2.6
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	2.8	3.0
Mali i Zi	3.5	1.8	4.1	4.7
Maqedonia	2.9	3.5	3.7	3.6
Serbia	2.6	-1.8	0.7	1.8
Shqipëria	1.1	2.0	2.6	3.4

Burimi: WEO (2016)

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor në muajt e parë të vitit 2016 u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, ndikuar kryesisht nga çmimet e ulëta të mallrave në tregjet ndërkombëtare. FMN-ja ka parashikuar se norma mesatare e inflacionit në vitin 2016 pritet të jetë 0.8 përqind. Shqipëria pritet të karakterizohet me shkallën më të lartë të inflacionit prej 1.9 përqind, përderisa Bosnja dhe Hercegovina pritet të ketë deflacion prej 0.7 përqind.

Në TM1 2016, norma e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan euro është zhvlerësuar për mesatarisht 2.2 përqind, përderisa është vlerësuar ndaj frankës zvicerane dhe sterlinës britanike për 2.2 përkatësisht 3.6 përqind. Në të njëjtën periudhë, euro u zhvlerësua ndaj lekut shqiptar dhe kunës kroate për 1.4 përkatësisht 0.8 përqind, përderisa është vlerësuar kundrejt denarit maqedon dhe dinarit serb për 0.2 përkatësisht 1.1 përqind.

Ekonomia e Kosovës

Sektori real

Ekonomia e Kosovës në vitin 2015, sipas vlerësimeve të BQK-së, ka shënuar rritje prej rreth 3.5 përqind, e ndikuar kryesisht nga rritja e investimeve dhe konsumit. Sa i përket vitit 2016, pritet që rritja reale e BPV-së të arrijë në rreth 3.7 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPV-së.

Të dhënat deri në mars 2016 sugjerojnë rritje të konsumit, që është ndikuar kryesisht nga rritja e kredive konsumuese, rritja e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë, etj. Rritja e konsumit mund të shpjegohet edhe nga rritja e konsiderueshme e importit të mallrave konsumuese, të cilat në TM1 2016 kanë shënuar rritje prej 13.1 përqind. Në anën tjetër, remitencat u karakterizuan me performancë më të dobët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke shënuar rënie.


Për sa i përket investimeve, investimet publike deri në mars të vitit 2016 janë karakterizuar me rritje të konsiderueshme (60.1 përqind). Poashtu, kreditë e reja investuese kanë shënuar rritje prej 13.0 përqind, gjë që pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në rritjen e investimeve të sektorit privat. Në anën tjetër, investimet e huaja direkte kanë shënuar rënie.

Me performancë më të dobët në TM1 2016 u karakterizuan edhe eksportet e Kosovës, ndërkohë që importet shënuan rritje të konsiderueshme (12.5 përqind) dhe ndikuan kështu në përkeqësimin e llogarisë rrjedhëse.

Çmimet

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), në TM1 2016 është karakterizuar me inflacion prej 0.1 përqind, krahasuar me deflacionin prej 0.4 përqind në TM1 2015 (figura 3).


Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Kjo ngritje e lehtë e nivelit të çmimeve është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të pijeve alkoolike dhe duhanit për 11.5 përqind, rritja e çmimeve të shërbimeve shëndetësore për 3.4 përqind, dhe rritja e çmimeve të veshmbathjes dhe orendive të cilat shënuan rritje për 2.4 përqind përkatësisht 2.0 përqind. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar te shërbimet e transportit, të cilat shënuan rënie për 4.2 përqind, pasuar nga kategoria e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse të cilat shënuan rënie për 3.5 përqind. Me rënie prej 0.3 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit të cilat përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 4).


Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Indeksi i çmimeve të konsumit në TM1 2016 ka treguar sjellje të ndryshme krahasuar me indeksin e çmimeve të importit, ku çmimet e konsumit kanë shënuar ngritje të lehtë ndërsa çmimet e importit kanë shënuar rënie (figura 5).

Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2016)

Çmimet e importit në TM1 2016 krahasuar me TM1 2015 shënuan rënie mesatare prej 4.4 përqind. Çmimet e produkteve minerale (kryesisht naftës dhe derivateve të saj), të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rënie më të lartë (18.6 përqind), pasuar nga çmimet e shtazëve të gjalla dhe produktet e shtazëve (10.0 përqind), metaleve bazë dhe artikujt prej tyre (8.8 përqind) si

dhe produktet bimore (2.7 përqind). Në anën tjetër, në kuadër të mallrave të importuara, çmimet e vajrave ushqyese dhe artikujve të ndryshëm të prodhuar shënuan rritjen më të lartë të çmimeve (14.3 përqind përkatësisht 4.0 përqind), pasuar nga çmimet e drurit dhe artikujt e drurit (2.4 përqind) (figura 6).

Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Indeksi i çmimeve¹ të prodhimit në vitin 2015 shënoi rritje mesatare vjetore prej 2.7 përqind. Rritja e çmimeve të prodhimit ishte më e theksuar te çmimet e prodhimit të produkteve kimike, pastaj çmimet energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar, çmimet e prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit. Në kuadër të çmimeve të prodhimit, rënia e çmimeve më së shumti ishte evidente te prodhimi i produkteve metalike, prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura, prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës (figura 7).

¹ Bazuar në kalendarin e publikimeve të ASK-së indeksi i çmimeve të prodhimit për TM1 2016 do të publikohet me 13 qershor 2016.


Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, në TM1 2016 është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në TM1 2016 ishte 2,896, që paraqet 314 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 727 ndërmarrje apo 226 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak (figura 8).


Figura 8. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2016)

Edhe gjatë TM1 2016, numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara ishte në sektorin e tregtisë me 820 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimitarisë me 343 ndërmarrje, hotelarisë me 249 ndërmarrje dhe bujqësisë me 261 ndërmarrje (figura 9). Kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, te sektori i prodhimit është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruara prej 67 ndërmarrje më shumë, pasuar nga sektori i tregtisë që u karakterizua me 36 ndërmarrje më shumë kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, në këtë periudhë, në sektorin e hotelarisë u regjistruan 4 ndërmarrje më pak dhe në sektorin e patundshmërisë 1 ndërmarrje më pak.

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2016)

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² deri në mars 2016 arritën vlerën bruto prej 340.6 milionë euro. Nëse zbriten 10.3 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 330.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.6 përqind. Shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën prej 333.1 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 14.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Rrjedhimisht, deri në mars 2015, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc buxhetor prej rreth -2.8 milionë euro krahasuar me bilancin buxhetor prej -5.1 milionë euro në mars 2015.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave kufitare të cilat arritën vlerën bruto prej 210.9 milionë euro që paraqet rritje prej 25.0 përqind. Të hyrat nga tatimet e brendshme arritën vlerën bruto prej 86.2 milionë euro që janë për 2.7 përqind më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje e të hyrave tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 247.3 milionë euro që paraqet një rritje prej 19.6 përqind. Në kuadër të tatimeve indirekte, TVSH-ja ka arritur vlerën prej 137.1 milionë euro që është për 15.2 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, akciza ka arritur vlerën prej 81.7 milionë euro apo 29.6 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar dhe detyrimi doganor ka arritur vlerën prej 28.5 milionë euro apo 15.9 përqind më shumë krahasuar me

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të hyrat tatimore direkte arritën vlerën bruto prej 54.2 milionë euro që janë për 3.8 përqind më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të hyrat jo-tatimore, ku përfshihen edhe të hyrat vetanake, arritën vlerën prej 39.0 milionë euro apo 13.9 përqind më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 7.3 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 135.7 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 7.0 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 99.1 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) kanë shënuar rritje për 18.0 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 40.6 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 15.3 përqind të gjithsej shpenzimeve, shënuan rritjen më të lartë, prej 60.1 përqind krahasuar me vitin paraprak dhe arritën vlerën prej 51.1 milionë euro.

Borxhi publik, në mars 2016, ka arritur në 799.2 milionë euro që është për 28.5 përqind më i lartë krahasuar me borxhin publik në mars 2015. Si përqindje e PBB-së, borxhi publik ka arritur në rreth 13.58 përqind nga 10.75 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 39.5 përqind (i cili ka arritur në 409.7 milionë euro), ndërkohë që edhe borxhi i jashtëm ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 18.5 përqind duke arritur në 389.5 milionë euro. Përderisa në vitet e kaluara borxhi publik dominohej nga borxhi i jashtëm, në mars të vitit 2016 borxhi i

² Në kuadër të të hyrave primare nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.


³ Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.

brendshëm kishte pjesëmarrje prej 51.3 përqind në gjithsej borxhin publik.

Sektori i Jashtëm

Deri në mars të vitit 2016, deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 108.4 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 30.6 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në të njëjtën periudhë, bilanci pozitiv në llogarinë e shërbimeve shënoi rritje.

Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2016)

Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 17.3 përqind në TM1 2016, përderisa suficiti në llogarinë e të ardhurave parësore dhe dytësore ishte më i ulët për 24.1 përkatësisht 6.7 përqind. Në të njëjtën periudhë, suficiti në tregtinë e shërbimeve ishte më i lartë për 33.3 përqind.

Eksporti i mallrave në TM1 2016 kishte vlerën prej 71.9 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 5.4 përqind (15.7 përqind rritje në TM1 2015) (figura

10).⁴ Rënia e vlerës së eksportit të mallrave në TM1 2016 kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 43 përqind) (figura 11).

Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Rënia e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve bazë u zvogëluar kryesisht si pasojë e rënies së prodhimit të nikelit në ekonominë e vendit në muajt e parë të vitit 2016, si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Me rënie u karakterizuan edhe eksportet e tekstitit dhe artikujve të tekstitit. Në anën tjetër, gjatë TM1 2016, eksportet e produkteve minerale, produkteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksportet e produkteve ushqimore u karakterizuan me rritje.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara në TM1 2016 arriti në 561.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.5 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i metaleve

⁴ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është ASK, që është dhe prodhues zyrtar i këtyre statistikave.

Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2016)


bazë, importi i makinerive dhe i pajisjeve mekanike dhe elektrike, si dhe importi i mjeteve të transportit (figura 12). Deri në mars 2016, deficitin në llogarinë e mallrave arriti vlerën prej 489.9 milionë euro, ndërkohë që rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të importuara u përkthye në zvogëlim të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 12.8 përqind në TM1 2016 (15.2 përqind në TM1 2015).

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 79.4 milionë euro deri në mars të vitit 2016 (59.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2015). Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara në TM1 2016 shënoi rritje vjetore prej 5.3 përqind, duke arritur në 150.6 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 14.7 përqind dhe arriti në 71.2 milionë euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportuara, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 11.9 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit si dhe kategoria e shërbimeve të biznesit u karakterizuan me rënie prej 21.2 përqind përfshirë 6.8 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore

të shërbimeve, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit, u karakterizuan me rënie prej 14.5 përqind përkatësisht 14.8 përqind.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rënie prej 24.1 përqind të bilancit pozitiv në TM1 2016. Përderisa të ardhurat nga kompensimi i punonjësve⁵ u zvogëluan për 8.6 përqind, të ardhurat e realizuara nga investitorët e huaj direkt shënuan rritje për 8.5 përqind.

Figura 13. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Bilanci më i ulët i të ardhurave dytësore gjatë TM1 2016 kryesisht i atribuohet nivelit më të ulët donacioneve dhe granteve të ndryshme, por edhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Gjithashtu, remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, në TM1 2016 shënuan vlerën prej 156.5 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.2 përqind (figura 13). Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht


⁵ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 37.8 përqind përkatësisht 21.3 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.6 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë, në TM1 2016, arritën vlerën prej 72.0 milionë euro që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vlerën prej 82.7 milionë euro të regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit 2015. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me zvogëlim të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 71.4 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën prej 55.7 milionë euro e cila është për 9.6 përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 16.3 milionë euro e cila është për 22.5 përqind më e ulët kundrejt vitit paraprak (figura 14).

Zvogëlim i IHD-ve në Kosovë u evidentua në sektorin e patundshmërive, sektor që shënoi vlerën prej 44.5 milionë euro (11.5 milionë euro më pak krahasuar me TM1 2015), pastaj sektori i shërbimeve financiare që kishte vlerën prej 14.1 milionë euro (7.4 milionë euro më pak krahasuar me TM1 2015), etj. Në anën tjetër, sektorët e ekonomisë që u karakterizuan me rritje të IHD-ve ishin sektori i shërbimeve tregtare, sektori i transportit dhe sektori i bujqësisë. Vlera e IHD-ve në sektorin e shërbimeve tregtare arriti në 4.2 milionë euro (2.5 milionë euro më shumë krahasuar me TM1 2015), në sektorin e transportit 4.1 milionë euro (4.6 milionë euro më shumë krahasuar me TM1 2015), në sektorin e bujqësisë 0.8 milionë euro (0.6 milionë euro më shumë krahasuar me TM1 2015), etj.

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Sistemi Financiar

Në mars 2016, vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.96 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 5.7 përqind. Ndikimin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend e kishin sektori bankar dhe sektori pensional.

Figura 15. Asetet e sistemit financiar, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Sektori Bankar

Asetet

Sektori bankar në TM1 2016 rriti vlerën e asetëve në 3.40 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 4.5 përqind (6.5 përqind në TM1 2015) (figura 16). **Kontribuesi më i madh në rritjen e asetëve të sektorit bankar ishte zgjerimi i portfolios së kredive që vazhdon të jetë kategoria më e madhe në strukturën e asetëve të sektorit bankar.** Rritja e aktivitetit të sektorit bankar reflekton edhe ecurinë e qëndrueshme të depozitave, të cilat po ashtu shënuan rritje edhe pse me ritëm më të ngadalësuar. Ky ritëm i rritjes së depozitave u reflektua edhe në rritjen më të ngadalësuar të asetëve të sektorit bankar.

Figura 16. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Kategoria e letrave me vlerë u karakterizua me një rritje të përshpejtuar prej 16.8 përqind për dallim nga rritja prej 2.1 përqind në TM1 2015. Zgjerimi i portfolios së letrave me vlerë gjatë vitit i atribuohet kryesisht rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, për dallim nga viti paraprak kur investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës kishin shënuar rritjen më të madhe. Në TM1 2016, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja u karakterizuan me rritje të theksuar prej 22.1 përqind krahasuar me rënie prej 23.1 përqind të shënuar në TM1 2015. Ndërsa, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan rritje vjetore prej 11.3 përqind, e cila paraqet rritje dukshëm më të ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 54.4 përqind të shënuar një vit më parë. Këto zhvillime mund të jenë pasojë e uljes së normës mesatare të interesit në letrat me vlerë të emetuara nga qeveria e Kosovës dhe njëkohësisht rritjes së normave të interesit në letrat me vlerë të qeverive të huaja.

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në po ashtu shënuan rritje gjatë TM1 2016 edhe pse me një ritëm më të ngadalshëm krahasuar me

periudhën paraprake. Paraja e gatshme u karakterizua me rritje vjetore prej 5.9 përqind krahasuar me rritjen prej 14.9 përqind të shënuar në TM1 2015. Rritja e ngadalësuar e kësaj kategorie mund të jetë ndikuar nga rritja e investimeve të bankave në sektorin e jashtëm. Ndikim mund të ketë pasur edhe rritja më e ngadalësuar e depozitave gjatë TM1 2016, duke ndikuar kështu në uljen e rezervave të bankave prej 3.7 përqind krahasuar me rritjen prej 16.8 përqind në TM1 2015.

Këto zhvillime ndikuan gjithashtu në zvogëlimin e bilancit me bankat komerciale. Kjo kategori regjistroi rënie vjetore prej 28.4 përqind në TM1 2016, krahasuar me rritjen prej 15.6 përqind të shënuar në TM1 2015. Kjo rënie mund t'i atribuohet orientimit të fondeve për investime në letra me vlerë.


Kreditë

Kreditë e sektorit bankar vazhduan të karakterizohen me rritje të përshpejtuar që nga viti paraprak duke dyfishuar normën e rritjes. Në TM1 2016, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.07 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.8 përqind (4.3 përqind në TM1 2015) (figura 17). Rritja e kreditimit gjatë vitit 2015 dhe TM1 2016 kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës për kredi si nga ekonomitë familjare ashtu edhe nga ndërmarrjet. Po ashtu, ndikim patën edhe standardet dhe kushteve e kreditimit të aplikuara nga ana e bankave, të realizuar përmes uljes së normave të interesit dhe zgjerimit të shumës së kredisë.

Kontribut në rritjen e përshpejtuar të gjithsej kreditimit të sektorit dhanë kreditë ndaj

ndërmarrjeve, të cilat edhe kanë peshën kryesore në kuadër të kredive (65.2 përqind të gjithsej kredive).


Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 6.2 përqind në TM1 (2.9 përqind në TM1 2015) (figura 18).

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2016)

Ndërsa, rritjen më të lartë vjetore e shënuan kreditë ndaj ekonomive familjare të cilat gjatë TM1 2016 shënuan rritje prej 14.1 përqind (10.8 përqind në TM1 2015). Kjo performancë i atribuohet kryesisht rritjes prej 18.3 përqind të kredive të reja konsumuese, rritjes prej 17.6 përqind të kredive të reja hipotekare, si dhe rritjes prej 90.7 përqind të kredive të reja me kushte favorizuese.

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari dhe ndërtimtari (figura 19).

Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (Mars 2016)




Burimi: BQK (2016)

Sa i përket tendencave të fundit të kreditimit të sektorëve të ekonomisë, deri në TM1 2016, kreditimi i të gjithë sektorëve shënoi rritje. Përfundimisht bën sektori i ndërtimtarisë ecuria e të cilit vazhdon të ketë vlerë negative, mirëpo është përmirësuar në krahasim me TM1 2015.

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditimi për sektorin e shërbimeve financiare regjistroi rritjen më të theksuar vjetore duke e dyfishuar atë në 27.7 përqind.

Normën e dytë më të lartë të rritjes prej 10.7 përqind (5.5 përqind në TM1 2015) e regjistroi kreditimi i sektorit të prodhimit që paraqet një përmirësim të theksuar. Si rezultat, i performancës pozitive të sektorit të prodhimit, gjithsej sektori i industrisë arriti të shënoi rritje vjetore të konsiderueshme në 3.0 përqind (0.5 përqind në TM1 2015) (figura 20).

Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Kreditimi i sektorit të tregtisë dhe bujqësisë, ngjashëm me vitin paraprak, vazhdon të ketë rritje të qëndrueshme. Më specifiku, sektori i bujqësisë shënoi rritje prej 9.5 përqind dhe ai i tregtisë shënoi rritje prej 3.5 përqind. Rritja e kreditimit të sektorit të tregtisë, ndër tjerash, mund t'i atribuohet rritjes së importit gjatë TM1 2016.

Në anën tjetër, përkundër rënies së normave të interesit nga ana e bankave, kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë vazhdon të zvogëlohet edhe pse me një ritëm më të ngadalshëm se sa vitin paraprak. Në TM1 2016, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë regjistruan rënie vjetore prej 4.9 përqind (rënie prej 9.0 përqind në TM1 2015).

Figura 21. Kreditë sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’. Megjithatë, vërehet një tendencë e zhvendosjes drejt kreditimit afatgjatë (figura 21).

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar gjatë TM1 2016 u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes. Rritje më të theksuar shënuan kreditë për sektorët që kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, si sektori i prodhimitarisë, bujqësisë, shërbimeve financiare dhe shërbimeve tjera.

Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë rreth 78.4 përqind të gjithsej detyrimeve, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në depozitat e mbledhura brenda vendit, dhe veçanërisht në depozita të ekonomive familjare të cilat konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit, eviton


ekspozimin e sektorit ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme financiare.

Me rritje të theksuar u karakterizuan edhe mjetet vetanake të sektorit bankar, që janë kategoria e dytë për nga pjesëmarrja me 12.1 përqind në gjithsej detyrimet e sektorit. Mjetet vetanake shënuan rritje vjetore prej 18.9 përqind (19.9 përqind në TM1 2015). Rritja ishte kryesisht si rezultat i rritjes së profitit të realizuar nga sektori bankar gjatë TM1 2016.

Depozitat

Vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.66 miliardë euro në TM1 2016, që paraqet rritje vjetore prej 3.5 përqind (5.9 përqind në TM1 2015) (figura 22). Rritjes së depozitave në përgjithësi, ndër tjerash, mund t'i ketë kontribuar edhe ndërprerja e trendit rënës së normave të interesit në depozita që nga tremujori i dytë i vitit 2015.

Figura 22. Depozitat, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Sa i përket ecurisë së depozitave, ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare si kategoria kryesore (figura 23).

Në TM1 2016, depozitat e ekonomive familjare regjistruan normë vjetore të rritjes prej 4.5 përqind (6.3 përqind në TM1 2015).

Figura 23. Struktura e depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Depozitat e ndërmarrjeve përbëjnë 20.1 të gjithsej depozitave, ato shënuan rritje vjetore prej 2.7 përqind (5.1 përqind në TM1 2015).

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka ndjekur trend të ngjashëm me vitin paraprak. Depozitat e afatizuara vazhduan të ngushtojnë pjesëmarrjen në strukturë me një ritëm të theksuar që nga viti 2013 pavarësisht faktit që normat e interesit në këtë kategori të depozitave shënuan rritje gjatë TM1 2016 në krahasim me TM1-rë të viteve paraprake. Ndërsa, depozitat e transferueshme vazhduan trendin rritës së pjesëmarrjes në gjithsej depozitat (figura 24).

Figura 24. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


Edhe pse gjithsej depozitat e afatizuara janë karakterizuar me rënie, në kuadër të strukturës së tyre vërehet një zhvendosje e theksuar drejt afateve më të gjata të maturimit. Këto lëvizje janë konform lëvizjeve të normave të interesit, të cilat mbesin më të larta në depozitat me maturitet më të gjatë.

Gjatë TM1 2016, depozitat e sektorit bankar vazhduan rritjen, edhe pse me ritëm më të ngadalësuar. Pavarësisht rritjes së lehtë të normave të interesit në depozita, trendi i ngushtimit të depozitave të afatizuara dhe zgjerimit të depozitave të transferueshme vazhdoi edhe gjatë kësaj periudhe.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kredi gjatë TM1 2016 u zvogëlua në 7.4 përqind (8.9 përqind në mars 2015), përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 0.9 përqind (0.8 përqind në mars 2015). Dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozita u zvogëlua në 6.5 përqind (8.1 përqind në mars 2015) (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2016)

Normat e interesit në kredi

Gjatë TM1 2016, norma mesatare e interesit në kredi vazhdoi të bie si në kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe në ato ndaj ekonomive familjare. Rënia ishte më e theksuar në kreditë ndaj ndërmarrjeve, e cila ndikoi që norma mesatare e interesit të ishte më e ulët krahasuar me atë të ekonomive familjare (figura 26).

Figura 26. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2016)

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 7.0 përqind. Në kuadër të këtyre kredive, kreditë investuese

vazhdojnë të karakterizohen me normat më të ulëta të interesit me një mesatare prej 6.8 përqind ;ndërsa, norma mesatare e interesit për kreditë jo-investuese shënoi rënie në 7.3 përqind. Faktorët që mund të kenë ndikuar në rënie të normës mesatare të interesit janë rritja e vazhdueshme e depozitave, konkurrenca më e madhe për kreditim, dhe rënia e kredive jopërfomuese (figura 27).

Figura 27. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2016)

Sipas afatit të maturimit të kredive të ndërmarrjeve, norma më e ulët e interesit (6.3 përqind) u regjistrua te kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri ne 10 vite’; ndërsa, norma më e lartë e interesit (7.7 përqind) u regjistrua të kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 vite deri në 5 vite’.

Sa i përket veprimtarive ekonomike, me rënie të normave të interesit u karakterizuan kreditë për të gjithë sektorët e ekonomisë. Rënie më e lehtë u shënuar në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe industrisë; ndërsa, rënie më e theksuar u shënuar në kreditë ndaj ‘sektorëve tjerë’ dhe sektorit të shërbimeve.

Figura 28. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Në mars 2016, norma mesatare e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë u zvogëlua në 8.8 përqind (figura 28). Zvogëlimi i normës së interesit për këto kredi vlerësohet të ketë qenë kontribuues i rëndësishëm i përshpejtimit të rritjes vjetore të kredive për sektorin e bujqësisë, i cili vazhdoi të mbetet njëri prej sektorëve ekonomik me rritjen vjetore më të lartë të kreditimit. Gjithashtu, edhe norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë shënoi rënie (në 7.1 përqind), që pasoi me rritje vjetore të lehtë të kredive të këtij sektori (në 3.0 përqind). Për më tepër, norma mesatare e interesit ndaj sektorit të shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë që përfaqëson 70.9 përqind të gjithsej stokut të kredive të shërbimeve) shënoi rënie prej 2.2 pikë përqindje (në 6.8 përqind). Ndërsa, rënien më të theksuar të normës mesatare të interesit prej 2.6 pikë përqindje (në 6.8 përqind) e shënuan ‘sektorët tjerë’ ekonomik.

Sa i përket kredive për ekonomitë familjare, në mars 2016, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 8.1 përqind. Te kreditë konsumuese, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 8.2 përqind), pasuar nga kreditë hipotekare në 7.2

përqind. Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma të interesit më të ulëta krahasuar me ato afatshkurtra. Norma më e ulët e interesit (6.7 përqind) u regjistrua te kreditë hipotekare me afat maturimi ‘mbi 10 vite’, ndërsa ajo më e larta (7.5 përqind) u regjistrua te kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 vite deri në 5 vite’.

Figura 29. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare




Burimi: BQK (2016)

Normat e interesit në depozita

Në mars 2016, norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat ka shënuar rritje të lehtë (0.9 përqind) krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak (0.8 përqind). Kjo rritje kryesisht reflekton rritjen e normës së interesit në depozitat e ekonomive familjare, të cilat dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar (74.7 përqind). Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve shënoi rënie të lehtë, me gjithë se vazhdon të mbetet më e lartë krahasuar me normën e interesit për depozitat e ekonomive familjare (figure 30).


Figura 30. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2016)

Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëluar në 1.2 përqind (1.3 përqind në mars 2015) (figura 31). Në kuadër të kësaj kategorie, rënia e normës mesatare të interesit (në 1.2 përqind) në depozitat e afatizuara ndikoi drejtpërdrejtë në zvogëlimin e normës mesatare të interesit në depozitat e ndërmarrjeve. Sa i përket afatit të maturimit, normat më të ulëta të interesit (0.2 përqind) ishin të pranishme në depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 muaj deri në 3 muaj’, kurse normat më të larta (1.4 përqind) u aplikuan në depozitat me afat maturimi ‘mbi 6 muaj deri në 1 vit’.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2016)

Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, për dallim nga ato të ndërmarrjeve, u ngritën në 0.9 përqind (0.7 përqind në mars 2015). Trendi pozitiv i normës mesatare të interesit në depozita kryesisht reflekton rritjen e lehtë të normës së interesit në depozitat e afatizuara, pasi që norma e interesit në depozitat e kursimeve nuk ka pasur ndryshime domethënëse që nga marsi i vitit 2015 (figura 32).

Në kuadër të depozitave të afatizuara, norma më e ulët e interesit (0.2 përqind) u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘deri në 1 muaj’, përderisa ajo më e larta (1.9 përqind) u regjistrua në depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’.

Figura 32. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2016)

Performanca e sektorit bankar

Në tremujorin e parë të vitit 2016, profiti i realizuar nga sektori bankar arriti në 16.8 milionë euro, që paraqet vlerë më të ulët të profitit krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak (19.9 milionë euro). Rënia e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve ndikuan në ngadalësimin e profitit të sektorit bankar.


Figura 33. Profiti neto i sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Të hyrat e sektorit bankar vazhdojnë të përcjellin një trend rënës. Ato shënuan vlerën 57.6 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 3.5 përqind. Kontributin kryesor në rënie e gjithsej të hyrave e kishte rënia e të hyrave nga interesi, që ishte si rezultat i zvogëlimit të normës mesatare të interesit në kredi, pavarësisht rritjes së gjithsej kredive gjatë tremujorit të parë të vitit 2016 (figura 34).

Figura 34. Vlera e të hyrave sipas kategorive, rritja vjetore




Burimi: BQK (2016)

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 40.8 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.7 përqind. Në rritjen e gjithsej shpenzimeve, kontributin kryesor e kishte rritja e

shpenzimeve të jointeredit, si dhe rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative (figura 35).


Figura 35. Vlera e shpenzimeve sipas kategorive, rritja vjetore



Burimi: BQK (2016)

Si rezultat i rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit është përkeqësuar duke arritur në 70.8 përqind në mars 2016, krahasuar me 66.6 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 36).

Figura 36. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar




Burimi: BQK (2016)

Zvogëlimi i profitit në TM1 2016 ka ndikuar në rënie e vlerës së treguesve të profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në

Mesataren e Kapitalit (KMK), duke e ndalur kështu trendin rritës që ishte në tri vitet e kaluara. Treguesi i profitabilitetit KMA shënoi rënie në 2.0 përqind, përderisa KMK shënoi rënie në 16.6 përqind (figura 37).

Figura 37. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2016)

Treguesit e shëndetit financiar

Gjatë TM1 2016, sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese, si dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e sektorit u zvogëluar në 5.9 përqind, si rezultat i rënies vjetore prej 21.2 përqind të vlerës së kredive joperformuese, në një rënë anë dhe, në anën tjetër, përsheptimit të rritjes së gjithsej kredive (figura 38). Vlera e kredive joperformuese është më e ulëta e regjistruar në vitet e fundit në sektorin bankar në Kosovë, si dhe më e ulëta krahasuar edhe me vendet e rajonit. Sa i përket provizioneve për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, ky indikator u rrit në 118.8 përqind. Për më tepër, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

(TMK) arriti në 19.7 përqind, që vazhdon të ketë nivel të kënaqshëm të kapitalizimit.


Figura 38. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së NPL-ve



Burimi: BQK (2016)

Gjithashtu, edhe treguesit e likuiditetit vazhdojnë të tregojnë pozicion të kënaqshëm (figura 39).

Figura 39. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës




Burimi: BQK (2016)

Gjatë TM1 2016, vlera e profitit të realizuar nga sektori bankar i Kosovës ishte 16.8 milionë euro, vlerë kjo e zvogëluar e profitit, si rezultat i rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve. Cilësia e portofolit kreditor shënoi përmirësim të mëtutjeshëm, duke arritur normën më të ulët të kredive joperformuese të regjistruar në vitet e fundit. Për më tepër, sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozicion të fuqishëm të likuiditetit.

Sektori pensional

Sektori pensional përbëhet nga dy fonde pensionale vlera e aseteve e të të cilave në TM1 2016 arriti në 1.27 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.3 përqind (figura 40).

Figura 40. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Në TM1 2016, vlera e gjithsej aseteve të Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), të cilat përbëjnë 99.5 përqind të gjithsej aseteve të sistemit pensional, arriti në 1.27 miliardë euro.

Kjo vlerë përkon me rritje vjetore prej 8.3 përqind, rritje kjo më e ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 23.2 përqind të regjistruar në TM1 2015. Ngadalësimi i rritjes së aseteve të FKPK-së i atribuohet ecurisë së performancës së kthimit në investime. Gjatë kësaj periudhe, kthimi në investime i FKPK-së ishte 6.2 milion euro, që paraqet një rënie prej 88.7 përqind krahasuar me kthimin e realizuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Zvogëlimi i përgjithshëm i kthimit në investime ishte pasojë e performancës më të dobët të investimeve të FKPK-së në sektorin e jashtëm, si shkak i zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Në ditën e fundit të

muajit mars 2016, çmimi i aksionit arriti në 1.32 euro (1.35 euro në mars 2015)..

Vlera e arkëtimeve të reja arriti në 36.1 milionë euro (rritje vjetore prej 10.6 përqind) në krahasim me vlerën e arkëtimeve në TM1 2015 prej 32.7 milionë euro (rritje vjetore prej 8.4 përqind).

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) shënoi rritje vjetore të aseteve dhe të arkëtimeve të reja gjatë TM1 2016. Vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të lehtë prej 0.5 përqind (10.6 përqind në TM1 2015). Ngadalësimi i rritjes së vlerës së aseteve të FSKP-së ishte pasojë e rënies së konsiderueshme në kthimin nga investimet. Vlera e kontributeve të arkëtuara arriti në 118.6 mijë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 25.3 përqind. Kjo paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me TM1 2015 kur u arkëtuan 94.6 mijë euro që përbën një rënie vjetore prej 10.9 përqind..

Kthimi bruto nga investimet e FSKP-së zbriti në 45.3 mijë euro, që është shumëfish më i ulët krahasuar me kthimin prej 208.3 mijë euro të regjistruar në TM1 2015. Ngjashëm me FKPK-në, performanca e investimeve të FSKP-së u ndikua nga lëvizjet në tregjet financiare globale gjatë TM1 2016. Në ditën e fundit të TM1 2016, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 145.63 euro (151.41 euro në TM1 2015).⁶


⁶ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100, për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

Spektori pensional gjatë TM1 2016 shënoi rritje më të ngadalshme të aseteve, në krahasim me vitin paraprak. Shkak për këtë kryesisht ishte performanca më e dobët e investimeve të fondeve në sektorin e jashtëm si rrjedhojë e zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Ndërsa, arkëtimi i kontributeve të reja shënoi përmirësim në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Spektori i sigurimeve

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 6.9 përqind në TM1 2016 (figura 41).

Figura 41. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2016)

Sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit (90.2 përqind të gjithsej aseteve të sektorit), dhe shënuan rritje vjetore prej 7.0 përqind. Pjesa e mbetur e aseteve përbëhet nga sigurimet jetë, asetet e të cilave shënuan rritje vjetore prej 6.3 përqind.


Aktiviteti

Vlera e gjithsej primeve të shkruara gjatë TM1 2016 shënoi rritje vjetore prej 3.0 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur primet e shkruara kishin shënuar rritje vjetore prej 0.3 përqind.

Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 96.4 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e tyre gjatë kësaj periudhe ishte 18.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.9 përqind. Ndërsa, pjesa e mbetur e primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit jetë të cilat arritën vlerën 0.7 milionë euro (rritje vjetore prej 7.8 përqind).

Gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në TM1 2016 shënuan rënie vjetore prej 7.1 përqind (rritje prej 13.0 përqind në TM1 2015) (figura 42). Në kuadër të tyre, dëmet e paguara nga sigurimet jo-jetë shënuan rënie prej 3.5 përqind (rritje prej 9.9 përqind në TM1 2015), po ashtu edhe dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) shënuan rënie, duke regjistruar një normë vjetore të rënies prej 40.0 përqind (rritje prej 37.6 përqind në TM1 2015).

Figura 42. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2016)

Zvogëlimi i vlerës së dëmeve të paguara krahas rritjes së primeve të shkruara, rezultoi në rënie të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 42).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Gjatë TM1 2016, sektori i sigurimeve regjistroi fitim në vlerë prej 0.5 milionë euro (humbje prej 131.1 mijë euro gjatë TM1 2015). Deri në TM1 2016, sigurimi jo-jetë realizoi fitim prej 369.2 mijë euro (humbje prej 256.8 mijë në TM1 2015), ndërsa sigurimi jetë regjistroi fitim në vlerë prej 129.4 mijë euro (125.7 mijë euro në TM1 2015).

Në anën tjetër, sektori i sigurimeve u karakterizua me përkeqësim të nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 90.8 përqind në TM1 2016 (121.7 përqind në TM1 2015), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve shënoi rënie në 80.2 përqind (104.2 përqind në TM1 2015). Raporti i detyrimeve ndaj gjithsej aseteve u karakterizua me rritje në TM1 2016 duke arritur në 67.3 përqind nga 64.8 përqind sa ishte në TM1 2015.


Sektori i sigurimeve gjatë TM1 2016 shënoi rritje të aseteve dhe primeve, kurse rënie të vlerës së dëmeve të paguara. Rritja e primeve krahas rënies së dëmeve të paguara gjatë kësaj periudhe, ndikoi në rënien e raportit ndërmjet dëmeve të paguara dhe primeve të shkruara. Performanca financiare e sektorit të sigurimeve shënoi përmirësim të lehtë, e karakterizuar me rritje të fitimit në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sektori mikrofinanciar

Asetet

Gjatë TM1 2016, sektori mikrofinanciar u karakterizua me zgjerim të theksuar të aktivitetit. Vlera e aseteve të sektorit arriti në 124.3 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 9.5 përqind (figura 43). Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar mbështetet kryesisht në huamarrjen nga sektori i jashtëm. Në mars 2016, gjithsej huamarrjet e jashtme arritën vlerën prej 65.6 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 8.5 përqind. Rritja e huamarrjeve prej sektorit të jashtëm është reflektuar kryesisht në rritjen e ndjeshme të aktivitetit kreditor (17.7 përqind) gjatë TM1 2016 (figura 43).


Figura 43. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë (71.2 përqind). Kategoritë tjera të rëndësishme për nga pesha janë lizingjet (17.1 përqind), pasuar nga bilanci me bankat komerciale, asetet fikse, asetet tjera, dhe para e gatshme (figura 44).

Figura 44. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2016)

Kreditë

Në mars 2016, vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar arriti në 88.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të theksuar prej 17.7 përqind, krahasuar me 1.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtte të vitit paraprak (figura 45).

Figura 45. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive




Burimi: BQK (2016)

Kontributin më të madh në rritjen e kredive të lëshuara nga sektori mikrofinanciar ekishte kategoria e kredive ndaj ekonomive familjare, e cila përfaqëson 64.9 përqind të gjithsej kredive të sektorit. Gjatë TM1 2016, kreditë ndaj ekonomive

familjare shënuan rritje vjetore prej 16.0 përqind, që tregon një rimëkëmbje të madhe krahasuar me rënien vjetore prej 1.8 përqind gjatë periudhës së njëjtte të vitit paraprak.

Në kuadër të strukturës së kredive ndaj ekonomive familjare po vërehet zhvendosje drejtë afateve më të gjata të maturimit. Në TM1 2016, struktura e kredive ndaj ekonomive familjare për herë të parë u dominua nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’, të cilat përfaqësuan 43.9 përqind të gjithsej kredive, për dallim nga vitet paraprake kur kjo strukturë dominohej nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ (figura 46).

Figura 46. Kreditë sipas maturitetit, në përqindje




Burimi: BQK(2016)

Rritje e theksuar u regjistrua edhe te kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat shënuan një normë vjetore të rritjs prej 20.9 përqind (8.0 përqind në mars 2015). Struktura e kredive të këtij sektori gjithashtu dominohet nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me 53.9 përqind të gjithsej kredive, pasuar nga kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ me 35.1 përqind.

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Si kategori kryesore në gjithsej kreditë e sektorit mbetën kreditë e destinuar për 'shërbime tjera' (31.4 përqind), pasuar nga kreditë bujqësore, kreditë për ndërtimtari, dhe kreditë për tregti. Sektori i industrisë mbetet me qasjen më të ulët në financimin mikrofinanciar (figura 47). Sektori i tregtisë e shënoi rënien më të theksuar vjetore në pjesëmarrje (17.5 përqind në mars 2015); ndërsa, kreditë e destinuar për 'shërbime tjera' shënuan rritjen më të lartë në pjesëmarrje (28.3 përqind në mars 2015).


Figura 47. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket ecurisë së kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë, kreditë e destinuar për kategorinë e 'shërbimeve tjera' regjistruan rritjen më të lartë vjetore (34.0 përqind), pasuar nga sektori i bujqësisë (24.5 përqind), sektori i ndërtimtarisë (19.2 përqind), dhe sektori i industrisë (18.5 përqind). Ndërsa, kreditimi i sektorit të tregtisë ishte sektori i vetëm që shënoi rënie vjetore prej 2.1 përqind (figura 48).


Figura 48. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Lizingjet

Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë për nga pesha (17.1 përqind) në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar, përkundër rënies vjetore prej 6.4 përqind që shënuan në mars 2016 (figura 49).

Figura 49. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar




Rënia e gjithsej lizingjeve kryesisht i atribuohet rënies vjetore prej 9.7 përqind të lizingjeve për ndërmarrje që përbëjnë 45.2 përqind të gjithsej lizingjeve të sektorit. Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrje, ishte kategoria e lizingjeve për pajisje që kryesisht ndikoi në rënien e kësaj kategorie, pasuar nga rënia e lizingjeve në kategorinë hipotekare. Për

më tepër, rënia e gjithsej lizingjeve i atribuohet edhe rënies vjetore prej 3.5 përqind të lizingjeve për ekonomitë familjare, të cilat përbëjnë 54.8 përqind të gjithsej lizingjeve të sektorit. Kontributin më të madh në rënie e lizingjeve për ekonomitë familjare e kishin lezingjet hipotekare (rënie prej 3.4 përqind), të cilat përbëjnë 92.6 përqind të gjithsej vlerës së lizingjeve familjare.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në mars 2016 zbriti në 23.1 përqind. Rënia e normës ishte më e theksuar në kreditë ndaj ndërmarrjeve krahasuar me atë të ekonomive familjare. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 21.1 përqind, ndërsa ajo ndaj ekonomive familjare në 24.2 përqind. (figura 50).


Figura 50. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë shënoi rënie dhe vazhdoi të mbetet më e ulëta (21.9 përqind) nga të gjithë sektorët ekonomik. Rënie shënoi edhe norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve (në 22.1 përqind).

Për dallim nga sektorët e lartpërmendur, norma mesatare e interesit në sektorin e bujqësisë shënoi rritje në 25.1 përqind, duke e renditur kështu si sektorin me normën më të lartë të interesit në kredi (figura 51).

Figura 51. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Performanca e sektorit mikrofinanciar

Gjatë TM1 sektori mikrofinanciar realizoi profit prej në vlerë prej 0.9 milion euro (0.4 milionë euro në mars 2015). Rritja e theksuar e profitit ishte kryesisht si rezultat i rritjes së ndjeshme të të hyrave, përderisa shpenzimet u rritën me ritëm më të ngadalësuar.

Sektori mikrofinanciar realizoi të hyra në vlerë prej 5.6 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 14.1 përqind. Rritja e të hyrave i atribuohet kryesisht rritjes së theksuar vjetore të të hyrave nga interesi prej 11.9 përqind, dhe të hyrave nga jointerеси prej 25.1 përqind.

Figura 52. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2016)

Ndërsa, shpenzimet arritën në 4.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.1 përqind. Rritja e shpenzimeve kryesisht i atribuohet rritjes vjetore të shpenzimeve nga interesi (7.2 përqind), si dhe rritjes së shpenzimeve tjera operative (17.8 përqind). Kurse, rënia e lehtë (0.4 përqind) në shpenzimet e jo interesit, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve (66.0 përqind), ka ndikuar që të ngadalësohet rritja e shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit gjatë TM1 2016 është zvogëluar në 83.6 përqind (figura 52). Ky përmirësim ishte si rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave të sektorit, dhe rritjes së lehtë të shpenzimeve. Rrjedhimisht, profiti i realizuar në TM1 2016 ndikoi në rritjen e treguesve të profitabilitetit. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) u rrit në 3.0 përqind, dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 10.4 përqind (figura 53).


Figura 53. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



*Për vitin 2016 profiti është aktualizuar me performancën deri në Mars 2016
Burimi: BQK (2016)

Sektorit mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese prej 4.2 përqind, dhe me nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive joperformuese prej 165.8 përqind (figura 54).

Figura 54. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK (2015)

Sektorit mikrofinanciar gjatë TM1 2016 u karakterizua me përshpejtim të aktivitetit dhe përmirësim të theksuar të performancës financiare krahasuar me vitet e fundit. Normat e interesit në kredi shënuan rënie; ngjashëm, edhe niveli i kredive joperformuese shënoi rënie.

Tregu i letrave me vlerë


Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, gjatë TM1 2016 janë mbajtur 6 ankande për emetimin e letrave me vlerë, në vlerë të shpallur nominale prej 120.0 milionë euro. Ndërsa, vitin e kaluar janë mbajtur gjithsej 5 ankande ku u emetuan letra me vlerë në vlerë nominale prej 100.0 milionë euro.

Gjatë TM1 2016, qeveria e Kosovës ka emetuar numër dhe vlerë më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Numri i bonove të thesarit të emetuara ishte 3 (4 deri në TM1 2015), krahas rënies në numër emetimi i bonove të thesarit shënoi rënie edhe në vlerë, e cila u zvogëluar në 60.0 milionë euro (80.0 milionë euro në TM1 2015). Në anën tjetër, emetimi i fletëobligacioneve shënoi rritje në numër dhe vlerë gjatë TM1 2016 krahasuar me vitin paraprak. Gjatë TM1 2016, u emetuan 3 fletëobligacione qeveritare në vlerë prej 60.0 milion euro (1 emetim në vlerë prej 20.0 milionë euro në TM1 2015).

Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovë, sipas afatit të maturimit, u karakterizua me ndryshime të theksuara gjatë viteve të fundit. Gjatë pesë viteve të fundit, letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër kanë ndjekur trend të theksuar rënës kundrejt zgjerimit të theksuar të peshës së letrave me maturitet afatgjatë. Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë edhe gjatë TM1 2016 vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë, pasuar nga fletëobligacionet me afat maturimi dy vite dhe fletëobligacionet qeveritare me afat maturimi tre vite

(figura 55). Një ndryshim i theksuar në strukturën e letrave me vlerë vërehet te pjesëmarrja e zvogëluar e bonove të thesarit me afat maturimi 91 ditë krahasuar me pesë vite më parë kur ato ishin kategoria e vetme e emetuar gjatë TM1 2016. Vlenë të ceket se gjatë TM1 2016 nuk është emetuar asnjë bono e thesarit me afat maturimi 182 ditë, ndryshim i konsiderueshëm në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ku kjo kategori përbënte 20.0 përqind të strukturës (figura 55).


Figura 55. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Që nga themelimi i tregut të letrave me vlerë në vitin 2012, shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit në shumicën e rasteve ka tejkaluar shumën e shpallur në ankande nga Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Në TM1 2016, raporti në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të shpallur në ankande ishte 2.65 herë më i lartë. Ky raport është më i lartë krahasuar me vitin paraprak (1.89 herë deri në TM1 2015) kryesisht si rezultat i ofertimit më të lartë nga ana e pjesëmarrësve dhe reflekton interesimin e lartë të subjekteve pjesëmarrëse, kryesisht të sektorit bankar, për të investuar në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Figura 56. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë TM1 2016 ishte më e ulët (1.53 përqind), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (1.77 përqind). Rënie më të madhe të normës së interesit e kishin fletëobligacionet me afatmaturimi 2 vite me ndryshim prej 1.6 pikë përqindje.

Gjatë këtij tremujori, norma më e lartë e interesit u regjistrua në fletëobligacionet me afat maturimi 5 vite, ndërsa ajo më e ulëta u regjistrua në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë (figura 56).

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2016): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 14 TM1 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2016):

- a) Buletini Mujo Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2016):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2016): Metal Prices database.

FAOUN (2016): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2016): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2016): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Mars 2015	Mars 2016
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	-0.43%	0.13%
Çmimet (fondi i periudhës)	-0.40%	0.10%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	285.6	330.3
Shpenzimet (në milionë euro)	290.7	333.1
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-5.1	-2.8
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,691.79	4,962.34
prej të cilave: Bankat	3,250.23	3,397.76
Kredi	1,903.52	2,070.25
Depozita	2,574.53	2,664.02
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	8.9	7.4
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	0.8	0.9
Hendeku i normës së interesit	8.1	6.5
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-30.6	-108.4
prej të cilave: remitencat e pranuar	160.0	156.5
Llogaria financiare	30.1	20.6
Investimet e huaj direkte në Kosovë	82.7	72.0
Investimet portfolio, net	4.9	80.6
Investimet tjera, net	81.8	-56.1
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net*	297.3	94.6
Asetet	4276.6	4519.2
Detyrimet	3979.3	4424.7
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1737.1	1931.5
Borxhi i jashtëm privat	1344.3	1489.7
Borxhi i jashtëm publik	392.8	441.8

Burimi:

1/ ASK (2016).

2/ MF (2016).

3/ BQK (2016).

*Për PNI dhe borxhin e jashtëm, të dhënat e fundit janë deri në dhjetor 2015.

